

Njoftim punimesh



Rruga Webster mbyllet te kalimi në nivel dhe punimet 24/7 fillojnë në tetor

Për t'u përgatitur për më shumë trena, të cilët do të jenë edhe më të shpeshtë pas hapjes së tunelit të metrosë më vonë këtë vit, do ta mbyllim rrugën Webster te kalimi në nivel dhe do të ndërtojmë një rrugë të re nën linjën hekurudhore. Nënkalimi i ri do të lidhë rrugën Princes Highway-Lonsdale me rrugët Cheltenham dhe Hammond.

Çfarë po bëjmë?

Rruga Webster do të mbyllet përgjithmonë te kalimi në nivel nga **ora 21:00, të premten më 10 tetor**. Shtegu i ri i përbashkët për ecje dhe çiklizëm përgjatë Rrugës Webster do të jetë i hapur për këmbësorë dhe çiklistë nga **ora 07:00, të premten, më 10 tetor**.

Me rrugën Webster të mbyllur te kalimi në nivel, do të ketë ndryshime në mënyrën se si udhëtoni nëpër Dandenong gjatë kohës që ndërtojmë nënkalimin rrugor të ri. Ju lutemi shikoni hartën në faqen vijuese.

Do të punojmë 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë në korridorin hekurudhor midis rrugës Cheltenham dhe rrugës Frankston-Dandenong për të përfunduar punimet e sinjalizimit, shinat dhe kabllot ajrore.

Punimet do të zhvillohen ditën dhe natën nga **ora 21:00, të premten, më 10 tetor deri në orën 02:00, të premten, më 24 tetor**, ndërsa trenat nuk do të jenë në qarkullim.

Çfarë mund të presim?

- Rruga Webster do të mbyllet përgjithmonë te kalimi në nivel nga **ora 21:00, të premten më 10 tetor**.
- Menaxhimi i trafikut do të organizohet për të ndihmuar shoferët, këmbësorët dhe çiklistët.
- Punimet do të zhvillohen 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë brenda korridorit hekurudhor.
- Rritja e zhurmës, dridhjeve, ndriçimit dhe pluhurit. Cisterna uji dhe pastrues rrugorë do të përdoren për të zvogëluar pluhurin

Qasja në biznese dhe shtëpi do të sigurohet në çdo kohë.

Do të bëjmë çdo përpjekje për të përfunduar punimet sipas planit. Megjithatë, datat dhe oraret mund të ndryshojnë.



Ndryshimet në mënyrën se si udhëtoni

Për të siguruar që ekipet të përfundojnë në mënyrë të sigurt punimet në korridorin hekurudhor, trenat do të zëvendësohen me autobusë në disa seksione të linjave Cranbourne dhe Pakenham **nga ora 20:30, të premten më 10 tetor, deri në shërbimin e fundit, të enjten më 23 tetor**.

Ju lutemi planifikoni më shumë kohë për të udhëtuar. Për më shumë informacion dhe për të planifikuar udhëtimin tuaj, skanoni kodin QR ose vizitoni **ptv.vic.gov.au/cranpak**

levelcrossings.vic.gov.au

1800 105 105 (telefononi në çdo kohë)

contact@levelcrossings.vic.gov.au



Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutemi të telefononi në 9209 0147.



Ju lutemi të na kontaktoni nëse dëshironi këtë informacion në një format të arritshëm. Nëse keni nevojë për ndihmë për shkak të një dëmtimi të dëgjimit ose të të folurit, vizitoni **relayservice.gov.au**



Rruga Webster do të mbyllet te kalimi në nivel nga ora 21:00, të premten më 10 tetor.



Për njerëzit që udhetojnë në rrugën Webster, rruga më e drejtpërdrejtë do të jetë nëpërmjet Hammond Road, Dandenong Bypass, Frankston-Dandenong Road, Princes Highway-Lonsdale Street, Foster Street dhe Cheltenham Road.

Mësoni më shumë rreth ndryshimeve në mënyrën se si udhëtoni duke skanuar kodin QR ose vizitoni levelcrossings.vic.gov.au/webster-travel-changes



Rrugët alternative gjatë mbylljes së rrugës Webster



Më shumë informacion

Nëse keni ndonjë pyetje ose dëshironi më shumë informacion lidhur me projektin, ju lutemi të dërgoni një email në contact@levelcrossing.vic.gov.au ose të na telefononi në **1800 105 105**, 24 orë në ditë.

Për të mësuar më shumë rreth projektit vizitoni levelcrossings.vic.gov.au/webster-street

Regjistrohuni për përditësime me email në levelcrossings.vic.gov.au/subscribe nën seksionin **Cranbourne-Pakenham Lines** zgjidhni **rrugën Webster, Dandenong**.

Qëndroni të informuar



Lajmet e fundit të projektit

facebook.com/levelcrossings



Na telefononi

1800 105 105
(telefononi në çdo kohë)



Lajmërime me SMS

Dërgoni një SMS me tekstin
WEBSTER në numrin
0428 581 917



Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutemi të telefononi në 9209 0147.

عربي – Arabic	اضغط الرقم 1	廣東話 – Cantonese	按2	ελληνικά – Greek	Πατήστε 3
Italiano – Italian	Premi 4	普通话 – Mandarin	按 5	Việt Ngữ – Vietnamese	Nhấn số 6
Albanian – Shqipëria	Shtypni 7	Serbian – Српски	Притисните 7	Dari – دری	7 را فشاردهید